



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
VU644-24-3684 -1-2-1/C886  
14 Nr. 436/24  
Dt. 12.07.2024

**KONTRATË FURNIZIMI**

**Palët kontraktuese :**

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Ilmi Azemi – Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**), dhe
2. “ **IBM “sh.p.k. emri i biznesit**, me seli në **Mitrovicë**, me **ARBK : 811384718**, të cilën e përfaqëson z. **Ermal Bajraktari** në tekstin e mëtejme: **FURNIZUESI**,

, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë: **Furnizimi me perde dhe tepiha**, me numër identifikues:

Nr. i prokurimit	VU644	2	4	36	8	4	1	2	1
Nr. i brendshëm	VU644	2	4	0	3	7	1	2	1

**Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës do të jetë : **Furnizimi dhe montimi i perdeve dhe tepihëve në Drejtorinë e Arsimit, Drejtorinë e Administratës dhe Kabinetin e kryetarit - Komuna Vushtrri**, në pajtim me Specifikat Teknike pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit dhe përfundon brenda afatit: **jo më gjatë se 30 ditë kalendarike pas datës së nënshkrimit të kontratës.**

1.3 Vendi i dërgimit do të jetë : **Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Administratës dhe Kabineti i kryetarit - Komuna Vushtrri**, në pajtim me Aneksin 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme, pjesë përbërëse e Dosjes së Tenderit dhe e kësaj Kontrate.

1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP<sup>1</sup>** (Detyra e Dërguar e Paguar).

**Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

**Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **19,284.03€ ( nëntëmbëdhjetmijdyqindtëdhjetekatër/03 Euro).**

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

#### **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pasi që Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i pranimit të mallit ( perdeve ) i Autoritetit Kontraktues të konfirmoi me shkrim pranim-dorëzimin e pajisjeve, respektivisht pas dorëzimit të Raportit me shkrim se pajisjet janë dorëzuar – pranuar nga A.K. , si në aspektin sasior ashtu dhe në aspektin cilësor. Raporti me shkrim i hartuar dhe nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës dhe Komisioni i pranimit të mallit do të dorëzohet, një kopje Kontraktuesit/Furnizuesit dhe një kopje Drejtorisë për Prokurim me qëllim të procedimit me pagesat për furnizimet dhe / ose shërbimet e përfunduara.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

#### **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

#### **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i furnizimeve dhe / ose shërbimeve është përgjegjësi e Furnizuesit ndërsa pajisa e dorëzuar duhet, në të gjitha aspektet, ti plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

#### **Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni për cilësinë e mallit do të mbetet përgjegjësi e furnizuesit. Kontraktuesi duhet të dorëzojë Polisën e sigurimit apo dokument bankar me afat validiteti për perjudhën kohore prej 13 muaj nga data e pranimit teknik të mallit. Dokumentit – Polisa e sigurimit e lëshuar nga një banke apo kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës për kualitetin e mallit – pajisjeve.

#### **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve dhe / ose shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

#### **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

#### **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.



### Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

### Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

### Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, në pajtim me ligjet në Republikën e Kosovës.

### Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:





- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (d) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

E hartuar në gjuhën Shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues:  
Komuna Vushtrri

Për Operatorin Ekonomik :  
" IBM "sh.p.k. – Mitrovicë

Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Ermal Bajraktari
Pozita:	drejtor	Pozita:	drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	12.07.2024	Data:	12.07.2024
Vula:		Vula:	

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: VU644-24-3684-1-2-1/C886

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <b>gjuha Shqipe</b> .
Siguria e ekzekutimit	9.1	<b>10%(dhjetë përqindë) e vlerës së përgjithshme të kontratës.</b> <b>Dokumenti - Polisa e sigurimit apo dokument bankar të lëshuar nga ndonjë kompani e sigurimeve apo bankë të licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës me afat validiteti për kohëzgjatjen e periudhës prej 60 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.</b>
Sigurimi	10.1	Incotermi i aplikueshëm është DDP (Delivery Duty Paid).
Programi i ekzekutimit	11	Programi për ekzekutimin e kontratës duhet të përgatitet Brenda dy ditëve pas nënshkrimit të kontratës.
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	DDP (Delivery Duty Paid)
Cilësia e furnizimeve	18.2	Autoriteti Kontraktues do të refuzojë çdo dergese të materilait i cili deshton në përmbushjen e specifikimeve minimale të cilësisë të përcaktuara në specifikimin teknik.
Inspektimi dhe testimi	19.2	
Pagesa	20.1	Pagesa do të bëhet nga ana e Autoritetit Kontraktues për furnizimet e dorëzuara vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje të vlefshme të lëshuar nga autoriteti kontraktues.
Dorëzimi	21.3	Furnizuesi do t'i bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me mallrat deri në pranimin në destinacion. Furnizimet duhet të paketohen në mënyrë që të parandalohet dëmtimi i tyre deri në destinacionin e tyre. <b>Dërgesa:</b> Dërgesat do të bëhet brenda 30 ditëve pas marrjes së "urdhër blerjes" nga ana e Furnizuesit. Dorëzimi do të bëhet në një ditë pune dhe gjatë orarit të punës të Autoritetit kontraktues (e hënë - e premte, 8:00-16:00).
Obligimet garancionit	24.1	Periudha garancionit e defekteve është : 12 muaj nga data e pranimit teknik.
Shërbimet pas shitjes	25.1	N/A
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Në pajtim me dispozitat e nenit 31 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatën Komerciale në Prishtinë</b>

Shtetimi: Te pershkrimi i cimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G. Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-se, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%, 8% apo 18%. Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy numra pas presëjes dhjetore

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-se në %	Çmimi për njësi (me TVSH)-€	Totali (pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
<b>I PERDE</b>									
1	Perde shiritore me gjeresi te shiritit prej 12.5 deri 13 cm - SIPAS PERSHKRIMIT NE ANEKSIN NR.1	m <sup>2</sup>	605.00	9.00	18.00	10.62	5445.00	960.10	6425.10
2	Perde pambuku te trasha per mbrojte te rezerve te diellit , - SIPAS PERSHKRIMIT NE ANEKSIN NR.1	m <sup>2</sup>	75.80	5.00	18.00	5.90	379.00	68.22	447.22
3	Perde zaber me mekanizem- SIPAS PERSHKRIMIT NE ANEKSIN NR.1	m <sup>2</sup>	229.17	20.00	18.00	23.60	4583.40	825.01	5408.41
4	Perde Zarba - SIPAS PERSHKRIMIT NE ANEKSIN NR.1	m <sup>2</sup>	157.50	20.00	18.00	23.60	3150.00	567.00	3717.00
5	Perde trake, SIPAS PERSHKRIMIT NE ANEKSIN NR.1	m <sup>2</sup>	18.00	10.00	18.00	11.80	180.00	32.40	212.40
6	PERDE JALUZZI -SIPAS ANEKSIT NR. 1	m <sup>2</sup>	50.00	10.00	18.00	11.80	500.00	90.00	590.00
<b>NENTOTALI I</b>							<b>14,237.40</b>	<b>2,562.73</b>	<b>16,800.13</b>
<b>II TEPH</b>									
<b>1 ZYRA E KRYETARIT</b>									
1.1	TEPHI PER KORIDORË DHE SHKALLË - POLIKROPEN OSE EKVIVALENT ME PERFOENCA TE NJETA-SIPAS PERSHKRIMIT NE ANEKSIN NR.1	m <sup>2</sup>	68.10	10.00	18.00	11.80	681.00	122.58	803.58
1.2	Polipropek tepih koridor-sipas pershkrimt ne Aneksin Nr.1	m <sup>2</sup>	17.40	10.00	18.00	11.80	174.00	31.32	205.32
1.3	TEPHI PER ZYRE AKRIL OSE EKVIVALENT ME PERFOENCA TE NJETA - SIPAS PERSHKRIMIT NE ANEKSIN NR.1	m <sup>2</sup>	7.50	20.00	18.00	23.60	150.00	27.00	177.00
<b>2 DREJTORIA E ARSIMIT</b>									
2.1	Tepi nga materiali polipropek me trashesi min 1.5cm, ngjyre e pershtatshme per femije me dimensione 300x200cm	cope	8.00	50.00	18.00	59.00	400.00	72.00	472.00



2.2	Tepi nga materiali polipropilen me trashësi më 1.5cm, ngjyrë e përshatshme për familje me dimensione 300x400cm	cope	2.00	50.00	18.00	59.00	100.00	18.00	118.00
2.3	Tepson termo me dimensione 8x4m	cope	1.00	200.00	18.00	236.00	200.00	36.00	236.00
2.4	Tepson termo antibakteriale, ngjyrë e kuqe, mm dimensione 8x4	cope	1.00	200.00	18.00	236.00	200.00	36.00	236.00
2.5	Tepson termo antibakteriale, ngjyrë KAFE, me dimensione 10x1	cope	1.00	200.00	18.00	236.00	200.00	36.00	236.00
<b>TOTALI II</b>							<b>2,105.00</b>	<b>378.90</b>	<b>2,483.90</b>

## REKAPITULIMI

Nr.	Përshkrimi	Vlera me TVSH në €
1	PERDE	16,800.13
2	TEPIH	2,483.90
TOTALI I PËRGJITHSHËM =		<b>16,342.40</b>
TVSH=		<b>2,941.63</b>
TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TVSH = I+II:		<b>19,284.03</b>

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	"IBM" SH.P.K.
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT	ERMAL BAJRAKTARI
TË OE:	
NËNSHKRIMI:	<i>[Signature]</i>
DATA:	08.05.2024
VULA:	<i>[Stamp]</i>

